



Republika e Kosoves
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Lipjanit

Opština Lipjan/Municipality of Lipjan

Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN
01 Nr.Br. 052101-36359
Data/Datum 17.07.2025



RAPORTI PËR ZBATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT NË KOMUNËN E LIPJANIT PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2025

Lipjan, Korrik 2025

1. Hyrje.....	3
2. Objektivat e Planit të Integritetit	3
3. Monitorimi dhe raportimi	4
4. Metodologjia e përdorur	4
5. Të gjeturat	5
6. Sfidat	9
7. Rekomandimet	9
8. Tabela.....	11

1. Hyrje

Plani i Integritetit është një dokument që vlerëson ligjshmërinë e punës, integritetin institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si institucioni dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve, ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe / ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

- Regjistrimi i cenueshmërisë të identifikuar dhe të vlerësuar për të gjitha fushat e funksionimit të komunës.
- Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zvogëluar cenueshmërinë e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e masave.

Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit bëhet vlerësimi i cenueshmërisë së integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të komunës. Të gjithë të punësuarit kanë pasur mundësi të marrin pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të komunës dhe të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve.

2. Objektivat e Planit të Integritetit

Objektiivi kryesor i Planit të Integritetit është të rrisë dhe të rendisë përpjekjet dhe burimet për të zvogëluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korrupsionit dhe të sjelljeve jo etike në komunë.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një platforme ku të gjithë individët dhe njësitë në komunë si dhe qytetarët mund të përfshihen në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në punën e organeve të administratës komunale.

- Krijimi i vetëdijes së publikut mbi rreziqet e korrupsionit, sensibilizimi i qytetarëve dhe bizneseve për rolin e tyre në zvogëlimin/eliminimin e korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.
- Përmirësimi i raportimit të rasteve të korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në komunë.
- Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve në sektorin publik dhe privat.
- Krijimi dhe mirëmbajtja e partneriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike si dhe forcimi i sundimit të ligjit.

3. Monitorimi dhe raportimi

Komuna e Lipjanit, sipas mandatit ligjor dhe planit vjetor të punës për vitin 2025, ka përgatitur dhe ka hartuar një raport gjithëpërfshirës për zbatimin e Planit të Integritetit të Komunës. Ky raport synon të sigurojë transparencë dhe llogaridhënie në proceset e zbatimit të masave të integritetit, duke përfshirë të gjitha veprimet e ndërmarra nga njësitë administrative të komunës. Plani i Integritetit është monitoruar nga kordinatorja e përzgjedhur, e cila ka mbledhur dhe analizuar të gjitha të dhënat nga drejtoritë dhe sektorët përkatës. Ky raport, i cili mbulon periudhën Janar – Qershor 2025, ka për qëllim të ofrojë një vlerësim të qartë dhe të detajuar të zbatimit të masave dhe veprimeve të planifikuara.

4. Metodologjia e përdorur

Gjatë monitorimit të Planit të Integritetit në Komunën e Lipjanit, janë ndjekur një sërë metodash për të siguruar një proces të plotë dhe të saktë:

- 1. Njoftimi fillestar:** Është dërguar një email njoftues të gjitha njësive të komunës lidhur me veprimet dhe obligimet e tyre sipas planit të veprimit;
- 2. Analiza e të dhënave:** Janë analizuar të gjitha masat dhe veprimet, duke përfshirë edhe ndonjë problematikë të hasur gjatë zbatimit;

3. Hartimi i raportit: Për të hartimin e Planit të Integritetit është formuar komisioni, duke përfshirë zyrtar nga secili drejtorat dhe njësi, rrjedhimisht të njëjtit kanë përgjegjësi të përcjellin zbatimin e Planit brenda sektorit. Pastaj në fund është hartuar një raport gjithëpërfshirës për zbatimin e Planit të Integritetit të Komunës së Lipjanit për periudhën Janar – Qershor 2024, bazuar në të dhëna narrative dhe statistike.


5. Të gjeturat

Nga analizat dhe të dhënat e mbledhura mbi zbatimin e Planit të Integritetit në Komunën e Lipjanit për periudhën Janar – Qershor 2024, janë nxjerrë këto rezultate të rëndësishme:

1. Fushat e rrezikut: Janë planifikuar dhe analizuar pesë fusha të përgjithshme të rrezikut, si dhe dhjetë fusha specifike të rrezikut. Kjo gjithëpërfshirëse ka për qëllim të sigurojë një vlerësim të plotë dhe të detajuar të çdo aspekti të mundshëm të rrezikut. Nga këto analiza, janë identifikuar 91 nënfusha të rrezikut dhe janë propozuar 111 masa/veprime për zbatimin e tyre.

2. Zbatimi i planit: Gjatë periudhës së parë të vitit 2025(Janar-Qershor), zbatimi i Planit të Integritetit ka shënuar një përparim të konsiderueshëm deri më tani. Shumica e masave të propozuara janë implementuar me sukses, duke reflektuar një përqindje të lartë të zbatimit. Nga gjithsej 91 fusha të rrezikut janë realizuar 85 prej tyre me 104 masa ose veprime të propozuara. Ndërsa, 5 fusha të tjera rreziku me 5 masa të propozuara janë realizuar pjesërisht, dhe 1 fushë e rrezikut me 2 masa mbeten ende të porealizuara.

Më poshtë janë paraqitur tabelat që tregojnë përqindjen e zbatimit të Planit të Integritetit për periudhën Janar-Qershor 2025.



Tabala 1. Fushat dhe masat e planifikuara në Plan të Integritetit




Tabela 2. Realizimi i masave të propozuara në Plan të Integritetit




Tabela 3. Realizimi total i nënfushave të parapara në Planin e Integritetit

6. Sfidat

Sfida të ndryshme kanë dalë në pah gjatë realizimit të Planit të Integritetit, duke përfshirë:

1. **Burimet e kufizuara:** Financimi dhe burimet njerëzore nuk kanë qenë gjithmonë në nivelin e kërkuar për të mbështetur të gjitha aktivitetet e planifikuara. Në disa raste, është vërejtur mungesë e fondeve për realizimin e aktiviteteve specifike, çka ka ndikuar në zvarritjen ose mosrealizimin e tyre.
2. **Kompleksiteti i koordinimit:** Koordinimi ndërmjet departamenteve të ndryshme ka kërkuar përpjekje të mëdha dhe ndonjëherë ka rezultuar në vonesa në zbatimin e detyrave përkatëse.
3. **Ndryshimet e papritura:** Faktorët e jashtëm, si ndryshimet ekonomike, lëvizjet politike apo edhe mungesa e stafit në disa drejtori, kanë ndikuar negativisht në dinamikën dhe ritmin e zbatimit të Planit.
4. **Mungesa e monitorimit të vazhdueshëm:** Në disa raste ka munguar një sistem i mirëfilltë i monitorimit dhe raportimit të progresit, duke bërë që disa ngecje të mos identifikohen me kohë.

1. Rekomandimet

Për të arritur zbatueshmërinë e plotë të Planit të Integritetit, Komuna e Lipjanit dhe menaxhmenti i saj duhet të tregojnë përkushtim të shtuar në çdo departament. Kryetari i Komunës duhet të kërkojë nga secila drejtori që të gjejnë format e duhura për të rritur zbatueshmërinë e plotë të këtij plani. Të gjitha drejtoritë duhet të raportojnë periodikisht për problemet, sfidat dhe avancimet në zbatimin e planit. Nevojiten veprimet në vijim:

1. **Planifikim paraprak për fushat e parealizuara:** Të gjitha fushat që nuk janë realizuar duhet të planifikohen paraprakisht dhe të përfshihen në planin vjetor të punës së drejtorive për vitin vijues. Kjo ndihmon në adresimin e vonësave dhe në përdorimin më efikas të burimeve.
2. **Kontroll më i saktë dhe monitorim i vazhdueshëm:** Të krijohet një mekanizëm i brendshëm i kontrollit dhe vlerësimit për të monitoruar zbatimin e Planit, me qëllim që të identifikohen devijimet në kohë dhe të ndërmerren masa korrigjuese.
3. **Trajnime të rregullta dhe inovative:** Duhet të vazhdojnë trajnime të shumta me zyrtarët komunalë mbi temat e integritetit dhe parandalimit të korrupsionit. Këto trajnime mund të përfshijnë seminare interaktive për të rritur ndërgjegjësimin dhe njohuritë praktike të stafit.
4. **Përmirësimi i performancës në drejtoritë e ngadalësuara:** Drejtoritë që kanë ngecur në zbatimin e Planit të Integritetit duhet të marrin masa konkrete për përmirësimin e performancës së tyre. Kjo përfshin vendosjen e objektivave të matshëm, ndarjen e përgjegjësi dhe monitorimin e vazhdueshëm të progresit.
5. **Përfshirje më e madhe e menaxhmentit të lartë:** Menaxhmenti i lartë duhet të jetë më i angazhuar në ndjekjen e zbatimit të planit, duke mbajtur takime të rregullta për të shqyrtuar progresin dhe për të adresuar çështjet në kohë reale.

Nr.	Fusha e Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masa e propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizmit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizmit	Mjetet e verifikimit	Vështirësitë	Rekomandimet
1.	Drejtimi dhe menaxhimi	Objektivat e zhvillimit të Komunës të paqarta dhe si dhe mos përfshirja e të gjitha fushave përkatëse për zhvillimin e Komunës në Planin Zhvillimor	Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal Sigurimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të të gjitha fushave përkatëse si dhe qytetarëve në zhvillimin e Planit Zhvillimor të Komunës	Zyra e Kryetarit dhe Drejtoritë përkatëse	12 muaj	Komuna e Lipjanit tashmë ka hartuar Planin Zhvillimor, dhe jemi në fazën finale të aprovimit nga Ministria përkatëse. Komuna tashmë ka miraturar Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2024-2029. Për hartimin e këtyre dokumentave, Komuna ka ndjekur të gjitha hapat ligjorë konform ligjeve në fuqi.	E Realizuar	https://lipjan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/01/Vendim-per-miratimin-e-Strategjise-per-zhvillim-ekonomik-lokal-te-Komunes-se-Lipjanit-2024-2029_compressed.pdf	Vonesat në aprovimin nga ana e MAPL-së	
2.		Përceptimi negativ publik dhe humbja e besimit të publikut në punën e administratës komunale dhe Kuvendit Komunal për shkak të transparencës së pamjaftueshme.	Përditësimi i informatave në Web faqen e Komunës dhe në të gjitha kanalet e tjera zyrtare. -Informimi i vazhdueshëm i qytetarëve me procedurat për hartimin dhe miratimin e	Sektori për Marrëdhëni e me Publikun/ Udheheqja e Sektorit me Kryetarin e Komunës, dhe Drejtorit.	Në vazhdimësi	Komuna e Lipjanit në bazë të Ligjit, bën publikimin e të gjitha akteve ligjore, vendimeve të Komunës. Njëkohësisht njofton qytetarët për gjithë veprimtarinë e saj, duke publikuar secilen informatë të nevojshme, përfshirë edhe punën e Kuvendit, konkretisht mbledhjet e tij online.	E Realizuar	https://lipjan.rks-gov.net/	Problemet e vazhdueshme me web faqet zyrtare të komunave në nivel vendi.	

			akteve me interes publik me qëllim të përfshirjes së tyre në vendimmarrje.							
3.		Mungesa e transparencës dhe konsultimeve me palë të jashtme të interesit gjatë hartimit të rregulloreve dhe buxheteve komunale.	Përgatitja e planit vjetor të konsultimeve publike. Publikimi i projekt rregulloreve në web faqen e komunës. Inicimi i diskutimeve me fokus grupe të veçanta/	Zyra për Informim në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, dhe Drejtoritë.	Në vazhdimësi	Duke respektuar të gjitha ligjet në fuqi, Komuna përgatitë dokumentete e nevojshme komunale, bën aprovimin e tyre në Kuvend, organizon diskutimet e nevojshme me qytetarë si dhe bën publikimin e tyre në të gjitha kanalet zyrtare.	E Realizuar	https://lipjan.ks-gov.net/		
4.		Mosndarja e detyrave dhe përgjegjësi të zyrtarë kyç financiar.	Deponimi i nënshkrimeve për zyrtarët kyç financiar.		Në fillim të vitit	ZKA cakton zyrtarët kyç financiar sipas UA 02-2009.	E Realizuar	Deponimet e nënshkrimeve në fillim të vitit buxhetor.		
5.		Mos kryerja e vetëvlerësimit objektiv të organizatës buxhetore brenda vitit buxhetor.	Në baza vjetor të kryhet vetëvlerësimi.		Çdo vit	Vetëvlerësimi i OB kryhet brenda afatit ligjor dhe është dërguar në MFT.	E Realizuar			
6.		Mos vlerësimi i performancës të çdo të punësuar dhe efekteve të punës.	Në baza vjetore të bëhet vlerësimi dhe nga çdo i punësuar kërkohet raportim i rregullt		Çdo vit	Deri me 31 Dhjetor çdo drejtori ka dërgur në zyrën e personelit vlerësimet e stafit punonjes në bazë objektivave të planifikuara.	E Realizuar	Vlerësimet e punëtorëve që dorëzohen tek zyra e personelit.		

			lidhur me detyrat e kryera.							
7.		Raportet vjetore nga auditimi i jashtëm pasqyrojnë opinione negative.	Zbatimi i rekomandimeve nga ZKA dhe NJAB.		6 muaj	Kryetari i Komunës harton planin për zbatimin e rekomandimeve të dala nga ZKA dhe kryhen dy rishikimet për progresin e zbatimeve të rekomandimeve.	E Realizuar	Plani i zbatimeve.		
8.		Mungesa e raporteve vjetore nga ekzekutivi për në Asamblen Komunale.	Zbatimi i rekomandimeve nga ZKA dhe NJAB.		6 muaj	Të gjitha drejtoratet dorëzojnë raportet 6 mujore dhe vjetore, nga të cilat krijohet raporti i punës së Kryetarit dhe raportohet për punën në Kuvendin Komunal dy herë në vit.	E Realizuar	Raporti gjashtë mujor i zyrës së Kryetarit. https://lipjan.rks-gov.net/96507-2/		
Nr.	Fusha e Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masa e propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizimit	Mjetet e verifikimit	Vështirësitë	Rekomandimet
1.	Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve	Mungesa e zbatimit të sistemit të menaxhimit të informacionit të burimeve njerëzore.	Sigurimi i zbatimit procedurave ligjore lidhur për menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në institucion, mirëmbajtja e SIMNJ-së.	Zyra e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi	Zhvillimi i të gjitha procedurave përmes SIMBNJ-ës.	E Realizuar	Linku- https://hrmis.rks-gov.net/login		
2.		Praktikat aktuale të rekrutimit jo adekuate.	Rrespektimi i Ligjit në procedurat e rekrutimit të stafit.	Zyra e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi	Zhvillimi i të gjitha procedurave të rekrutimit konform Ligjeve dhe Rregulloreve në fuqi si dhe përmes SIMBNJ-ës.	E Realizuar	Organogrami - Komuna e Lipjanit		

3.		Mosplotësimi i vendeve të punës me staf adekuat dhe të mjaftueshëm.	Zhvillimi dhe miratimi i Planit të Personelit.	Zyra e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi	Planfikimi i Planit të Personelit përmes SIMBNJ-ës si dhe strukturës organizative e cila miratohet në Kuvendin Komunal.	E Realizuar	<u>Organogrami - Komuna e Lipjanit</u>		
4.		Mungesa e trajnimeve profesionale dhe adekuate për stafin civil.	Hartimi i Planeve të trajnimit për zyrtarë të rinj, trajnimi i vazhdueshëm	Zyra e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi	Komuna dërgon zyrtarët në trajnime sipas fushës së punës që kanë.	E Realizuar	Raporti vjetor i trajnimeve.		
5.		Përshkrimet e vendeve të punës të nëpunësve të pa qarta.	Të realizohet rishikimi i detyrave të punës si dhe harmonizimi i tyre me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe detyrat të cilat kryhen nga zyrtarët.	Zyra e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve.	Pas aprovimit të strukturës organizative	Përgatitja e përshkrimit të vendeve të punës bëhet për të gjithë zyrtarët administrates komunale dhe zyrtarët e rinj nga momenti i zhvillimit të procedurës së rekrutimit.	E Realizuar	Dosjet Personale të zyrtarëve.		
6.		Mungesa e monitorimit për zbatimin e Kodit Komunal të Etikës për gjithë zyrtarët komunal përfshirë zyrtarët publik dhe të zgjedhurit dhe të emëruarit.	Funksionimi i komisionit për shqiptimin e masave disiplinore dhe raportimi i rregullt nga zyrtari sinjalizues.	Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyrtari Sinjalizues	Në vazhdimësi	Të gjithë zyrtarët bëjnë nenshkrimin e deklaratës së kodit të Etikës si dhe vazhdimisht bëhet mbikqyrja e tyre.	E Realizuar	Dosjet Personale të zyrtarëve.		

7.		Mungesa e informimit për kodin e etikës për stafin drejtues dhe stafin tjetër të Komunës.	Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë zyrtarët komunal dhe organizimi i takimeve për informim me përmbajtjen e Kodit dhe nënshkrimi i deklaratave për pranimin e kodit të etikës për çdo të punësuar.	Zyra e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi	Të gjithë zyrtarët njoftohen me kohë rreth kodit të etikës.	E Realizuar	Dosjet Personale të zyrtareve.		
8.		Mungesa e informimit dhe mos raportimi i dhuratave nga qytetarët tek punëtorët e Komunës (neni 17 dhe 18 i Rregullores (QRK - Nr. 04/2015 Për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës).	Krijimi i një regjistri për regjistrimin e dhuratave të pranuar nga nëpunësit. Informimi i stafit për rregullat e pranimin të dhuratave.	Zyra e Burimeve Njerëzore, të gjithë nëpunësit publik.	Në vazhdimësi	Njoftimi nga Burimeve Njerëzore e për pranimin e dhuratave.	E Realizuar	Raportet vjetore.		
9.		Nivel i ultë i intersimit dhe ndërgjegjësimit të zyrtarëve për raportimin e korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme	Njoftimi i zyrtarëve për adresimin e rasteve korruptive të zyratit sinjalizues.	Zyra e Burimeve Njerëzore, Kryetari Komunal dhe Kuvendit dhe Drejtoret e	Në vazhdimësi	Raportet periodike të sinjalizuesve.	E Realizuar			

		brenda institucionit.		Drejtorateve						
10.		Mosrrespektimi i orarit të punës nga stafit administrativ.	Monitorimi dhe mbikqyrja nga menaxherët e mesëm lidhur me prezencën e stafit në vendin e punës.	Zyra e Burimeve Njerëzore ,Kryetari i Komunës dhe Kuvendit dhe Drejtoret e Drejtorateve	Në vazhdimësi	Vijueshmëria e të gjithë zyrtarëve përcillet përmes sistemit të kartelave dhe në çdo fund muaj dërgohet të udhëheqsitë e drejtorateve dhe merren masat e nevojshme për mos rrespektim të orarit nga ana e punëtorëve.	E Realizuar	Vijueshmëria monitorohet përmes sistemit dhe raportet dërgohen tek drejtoritë përkatëse.		
Nr	Fusha e Rrezikut	Pershkrimi i rrezikut	Masa e propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizimit	Mjetet e verifikimit	Vështërsitë	Rekomadimet
1.	Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit dhe financave	Planifikimi jo adekuat i buxhetit vjetor komunal.	Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë planifikimit të buxhetit.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa (BF)	6 muaj	Stafi përgjegjës në hartimin e procesit të planifikimit të buxhetit sigurohet që ky proces të ketë një pjesëmarrje të të gjitha njësive organizative gjithnjë duke ju referuar respektimit adekuat të ligjeve, rregulloreve, politikave, udhëzimeve dhe manualeve.	E Realizuar	https://lipjan.rks-gov.net/buxheti/		
2.		Shpenzimi i buxhetit në mënyrë jo	Hartimi me kohë dhe miratimi i	Drejtoria për Buxhet dhe Financa (BF)	Çdo vit	Përshtatja e planifikimit të buxhetit me planin e shpenzimeve.	E Realizuar	https://lipjan.rks-gov.net/rapo		

		adekuate dhe jo mjaftueshëm transparent.	planit të shpenzimeve Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore. Publikimi i planit të shpenzimeve në web faqen e komunës . Të sigurohet mbikëqyrja e mbi zbatimin e buxhetit nga KPF. Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore dhe realizimin e buxhetit.	Zyra per Informim		Publikimi i shpenzimeve në baza mujore dhe periodike (tremujore) në web faqen e komunës.		<u>rte-serike-te-te-hyrave-</u>		
3.		Mospërcjellja e afateve ligjore në procesin e planifikimit dhe ekzekutimin e buxhetit.	Njoftimi me kohë i qarkores së brendshme buxhetore për zyrtarët autorizues, organizimi i dëgjimeve buxhetore dhe	Drejtoria per Buxhet dhe Financa	Në vazhdimësi	Bëhet përpilimi dhe njoftimi qarkorës së brendshme buxhetore nga ZKF për zyrtarët autorizues të programeve. Organizohen dëgjimet buxhetore me publikun dhe akterë tjerë.	E Realizuar	https://lipjan.rks.gov.net/korniza-afatmesme-buxhetore/		

			kompletimi i dokumentacionit për hartimin e buxhetit si dhe shpenzimi i buxhetit sipas dinamikës së planifikuar.			Si dhe bëhet shpenzimi i buxhetit në bazë të planit të shpenzimeve.				
4.		Mos azhurnimi i faturave të pranuar sipas afateve ligjore..	Raportimi mujor i pagesave të vonuara kërkohet nga Thesari-MFPT.	Drejtorja për Buxhet dhe Financa	Në vazhdimësi	Raportimi i rregullt mujor i pagesave të vonuara.	E Realizuar	https://lipjan.rks-gov.net/korniza-afatmesme-buxhetore/		
5.		Mosazhurnimi dhe ruajtja e dokumentacionit.	Krijimi hapësirës së veçantë për arkivë për Drejtorinë e Buxhetit caktimi i zyrtarit së arkivës së buxhetit.	Sektori TPR-DBF	Në vazhdimësi	Është bërë caktimi i hapësirës për arkivë të dokumentacionit të buxhetit dhe është caktuar zyrtari për arkivë.	E Realizuar	Arkiva e Komunës.		
6.		Raportimi jo efikas i planifikimit të buxhetit.	Përgatitja e raporteve të rregullta për Kuvend si dhe të plasohen në web faqen e Komunës.	Sektori TPR-DBF	Në vazhdimësi	Raportimi i rregullt në baza tremujore për kuvend dhe raport mujor në web faqe.	E Realizuar	https://lipjan.rks-gov.net/raportet-periodike-2/		
7.		Mos përfshirja e të gjithë tatimpaguesve në bazën e tatimit në pronë.	Identifikimi dhe regjistrimi me kohë i të gjitha pronave të cilat janë objekt i tatimit në pronë.	DBF - Sektori TPR	Në vazhdimësi	Azhurimi i gjithë kërkesave të bëra nga tatimpaguesit për ndryshime në databazën e TPR dhe plotësimin e të dhënave personale (ID e tatimpaguesit.	Pjesërisht e Realizuar	https://lipjan.rks-gov.net/raportet-periodike-2/		

8.		Mosazhurimi me kohë i ndryshimeve në kategorinë e objekteve në bazën e TP.	Rianketimi i pronave e ¼ e faturave të lëshuara.	DBF - Sektori TPR	Në vazhdimësi	Rianketimi i pronave e ¼ e faturave të lëshuara nga stafi përgjegjës.	E Realizuar	https://lipjan.rks.gov.net/raportet-periodike-2/		
9.		Inventarizimi dhe regjistrimi joefikas i aseteve komunale.	Të përditësohet regjistri i brendshëm i aseteve të komunës.	DBF-Zyrtari i Pasurisë	Në vazhdimësi	Regjistrimi i të gjitha blerejeve të pasurive kapitale në evidencën kontabël dhe SIMFK nga yrtari i pasurisë si dhe regjistrimi i pasurive jo financiare në evidencën kontabël dhe "programin E pasuria".	E Realizuar	Raporti gjashtë mujore të drejtoratit. https://lipjan.rks.gov.net/96507-2/		
10.		Mungesa e sigurisë së të dhënave në sistemet e teknologjisë informative si dhe përdorimi i tyre për qëllime jozyrtare.	Autorizimi i qasjeve në aplikacionet e IT-së, të cilat përdoren në drejtoritë dhe sektorët e ndryshëm. Të sigurohet informimi për të gjithë të punësuarit lidhur me rreziqet nga mashtrimet dhe korrupsioni që kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit dhe shfrytëzimin e të dhënave të kompjuterizuara.	Kryetari i Komunës, Drejtorja e Administratës, Buxhetit dhe sektori i TIK.	Në fillim të vitit buxhetor	Paisja me fjalekalime e zyrtarëve të caktuar për module të caktuara.	E Realizuar			

11.		Trajtimi jo adekuat i dokumentacionit zyrtar dhe informacionit.	Sigurimi i gjurmëve lidhur me dokumentacionet e pranuar në arkivë dhe daljen e tyre nga arkiva.	Administratë s dhe sektori i TIK	Në vazhdimësi	Komuna me objektin e ri tashmë ka hapsirën e veçantë për ruajtjen e dokumentacionit si dhe poashtu ekzistoni zyrtari si dhe lokacioni i caktuar për arkivimin e dokumentacionit financiar-lëndëve të pagesave.	E Realizuar			
Nr.	Fusha e Rrezikut	Pershkrimi i rrezikut	Masa e propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizimit	Mjetet e verifikimit	Vështersitë	Rekomadimet
1.	Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumentacionit Drejtoria e Administratës	Humbja e dokumenteve të rëndësishme dhe mungesa e gjurmëve për proceset e kryera.	1.Monitorimi dhe raportimi lidhur me dokumentet e shmangura dhe sigurimin e gjurmëve Tyre.	Drejtoria për Administratë Zyrtarë të arkivës	Pas tre mujave	Komuna ka ndërtuar një proces monitorimi për ruajtjen e lëndëve përmes sistemit të intranetit të komunës dhe përdorimit të sistemit "e-arkivës". Gjendja fizike dhe arkivi komunal janë të pajisura dhe kontrollohen rregullisht për humbje dokumentacioni. Është shtuar kontrolli i rreptë mbi ruajtjen e dokumentacioneve.	E Realizuar	Raport nga sistemi i intranetit dhe sistemit "E-arkivës". Raport nga drejtoria e administratës.	1.Problemet teknike dhe vonesat në funksionim in e plotë te sistemit elektronik të intranetit dhe "E arkivës".	
2.		Përdorimi i pa autorizuar i vulave për dokumentet zyrtare.	Monitorimi dhe raportimi i rasteve të përdorimit të vulave pa autorizim.	Drejtoria për Administratë Zyrtarë të arkivës	Çdo tre muaj	Përdorimi i vulave është rregulluar në përputhje me ligjin për vula. Vulat menaxhohen nga drejtorët përkatës të institucioneve. Monitorim i rasteve të përdorimit të tyre çdo tre muaj.	E Realizuar			
3.		Mungesa e hapsirës për arkivimin e dokumentacionit.	Krijimi i arkivës, ndarja dhe sigurimi i hapësirave për		6 muaj	Është krijuar një hapësirë e madhe e dedikuar për arkivimin e dokumentacionit me kushtet e nevojshme për	E Realizuar	Arkiva.		

			çdo drejtori me qëllim të arkivimit të dokumenteve.			të arkivuar të sistemuar në rafta të një hapësire të madhe.				
			Sigurimi dhe ruajtja elektronike e dokumentacionit(arkiva elektronike).			Është penguar nga ASHI marrja e shënime me USB dhe pranimit i shënimeve në PC e zyrtarëve				
Nr.	Fusha e Rrezikut	Pershkrimi i rrezikut	Masa e propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizimit	Mjetet e verifikimit	Vështersitë	Rekomadimet
1.	Auditimi i brendshëm	Mungesa e planifikimit të auditimit të bazuar në rrezik dhe auditimeve rast pas rasti	Planifikimi efektiv i auditimit i bazuar në rezultatet e vlerësimit të rrezikut dhe të monitorohet zbatimi i këtij plani si dhe të planifikohen masa përmirësuese në rast nevojë. Auditime sistematike sipas planit të punës të aprovuar.	Kryetari i Komunës, Komisioni i auditimit, Njësia e auditimit.	1 muaj	NJAB ka plani e aprovuar për vitin 2025.	E Realizuar	Plani strategjik 2025-2027 dhe Plani vjetor i aprovuar 2025.		
2.		Mungesa e mbikëqyrjes adekuate, profesionale mbi zbatimin e rekomandimeve.	Hartimi i një plani për zbatimin e rekomandimeve të auditimit. Raportim i rregullt mbi	Kryetari i Komunës, Komisioni i auditimit, Njësia e auditimit	3 muaj	NJAB ka raportuar në TM1 dhe pas kryerjes se gjashtë muorit përgatit raportin e progresit.	E Realizuar	Dy raporte të rishikimit, gjithashtu edhe rishikimet e planeve të zbatimit për		

			zbatimin e rekomandimeve të auditimit.			GP -Me rastin e pranimit të Draft raportit nga ZKA ka përgatitur komente dhe pas pranimit të raportit Final , është përgatitur planin e zbatimit.		auditimet e brendshme. Në këtë kemi edhe raportin e monitorimit nga NJQHAB-për punën e NJAB-së.		
3.		Mungesa e koordinimit ndërmjet Njesisë së AB, Komisionit të Auditimit dhe Kryetarit.	Takimet e NJAB-së me komitetin e auditimit të mbahen në periudhë periodike.	Kryetari i Komunës, Komisioni i auditimit, Njësia e auditimit.	3 muaj	Janë mbajtur dy takime me Komitetin e Auditimit gjatë viti 2024.	E Realizuar	Dy takime të mbajtura me komitetin e auditimit-procesverbale të takimeve.		
4.		Mungesa e kapaciteteve njerëzore brenda Njesisë së Auditimit.	Shtimi stafit të mjaftueshëm për funksionimin adekuat të Njesisë së Auditimit.	Kryetari i Komunës, Komisioni i auditimit, Njësia e Auditimit.	6 muaj	3 kapacitet sipas Ligjit për auditimin e brendshëm.	E Realizuar	Kontratat dhe çertifikatat dhe licencat e auditoreve.		
5.		Mungesa e dëshmimeve të mjaftueshme të auditimit lidhur me opinionin e dhënë.	Sigurimi i listës kontrolluese lidhur me dokumentet e rishikuara të auditimit.	Kryetari i Komunës, Komisioni i auditimit, Njësia e auditimit.	6 muaj	NJAB –krijon dosje fizike dhe elektronike për çdo auditim si dhe të gjeturat dhe rekomandimet i ka të bazuara në dëshmi të cilat komunikohen edhe me përgjegjësit e entiteve ku kryhet auditimi para se raportet të finalizohen.	E Realizuar	Dosjet fizike dhe elektronike për auditimet e kryra.		
Nr.	Fusha e Rrezikut	Pershkrimi i rrezikut	Masa e propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizimit	Mjetet e verifikimit	Vështersitë	Rekomadimet
1.	Drejtorati për Prokurim Publik	Përdorimi i procedurave të negociuara pa ndonjë arsytim.	Aplikimi i procedurave të hapura për të gjitha aktivitetet e prokurimit.	Prokurimi	Në vazhdimësi	Autoriteti Kontraktues vepron sipas dispozitave të Ligjit i cili rregullon këtë materie, Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik i ndryshuar dhe plotësuar me	E Realizuar	<u>E-Prokurimi (rks-gov.net)</u>	Vështirësia paraqitet atëherë kur kemi të bëjmë me	Shqyrtimi sipas Afateve Ligjore

						Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 të Republikës së Kosovës, Rregullorës për Prokurim Publik 001/2022, verisoni i Konsoliduar.11.11.2024 Gjithashtu edhe sipas vendimeve të OSHP-së.			kërkesa për rishqyrtim dhe eventualisht në ankesa në OSHP, që paraqet vonesa në lidhjen e kontratave për shkak të afateve të stërgjatura.	nga OSHP.
2.		Mostransparenca dhe mbikqyrja e pamjaftueshme e prokurimit Publik.	Publikimi në , “ E Prokurimi “ i njoftimeve dhe dokumenteve lidhur me procedurat e zhvilluar për çdo aktivitet të prokurimit. Përdorimi i platformës ‘E-Prokurimi ‘për të gjitha procedurat dhe llojet e prokurimit.	Prokurimi	Pas miratimit të Planit të Prokurimit	Publikimi i të gjitha njoftimeve, njoftim për kontratë, njoftim për dhënie të kontratës, njoftimi për nënshkrimin e kontratës, komunikimet me OE, apo palët e interesit, dhe të gjithë dokumentacioni i cili ka të bëjë me një procedurë të prokurimit është i publikuar në sistemin e “E-Prokurimit”, dhe gjithashtu pas nënshkrimi të kontratës e njehta si lëndë publikohet në web të Komunës.	E Realizuar	<u>E-Prokurimi (rks-gov.net)</u> 2. <u>https://kk.rks-gov.net/lipjan/?cat=328</u>		
3.		Pjesëmarrja e zyrtareve komunal në përgatitjen e e	Sigurimi i deklaratave nën betim për anëtarët e	Prokurimi	Në vazhdimësi	Sigurimi i deklaratave nën betim dhe nënshkrimi tyre nga ana e antëtareve të komisionit vlerësues, si dhe	E Realizuar	Deklaratat nën betim, për secilin vlerësim.		

		ofertës për ndonjë Operator Ekonomik	komisionit vlerësues si dhe Pengimin e pjesëmarrjes në komisionin e vlerësimit për zyrtarët të cilët kanë punuar tri vitet e fundit tek OE .			mos përfshirje të anëtarëve në komision të vlerësimit të cilët kanë punuar në 3 vitet e fundit në OE .				
4.		Kryerja e procedurave të prokurimit të cilat janë jashtë Planit të Prokurimit për vitin përkatës, pa njoftim në AQP.	Njoftimi i AQP-së për të gjitha aktivitetet e inicuar pa planifikim të prokurimit brenda afatit ligjor.	Prokurimi	Në vazhdimësi	1.Ne Autoriteti Kontraktues, sa herë që pranojmë kërkesa për inicim të procedurave të prokurimit nga ana e njësisë të kërkesës për procedurat të cilat janë jashtë Planit të Prokurimit, kërkojmë nga njësia kërkuese të jep arsyetim në Deklaratën – Disponueshmërinë një arsyetim se për cilën arsye nuk është përfshirë në Plan të Prokurimit për vitin përkatës. 2. Gjithashtu në kohë reale përcjellim në AQP njoftimin për zhvillimin e aktivitetit duke dërguar të skanuar njoftimin nga ana e Drejtorisë së Prokurimit, së bashku me kërkesë të njësive kërkuese, paramasën, disponueshmërinë .	E Realizuar	Para se me fillu procedurat e prokurimit dërgojmë njoftimin në AQP me komplet lëndën.		

Nr.	Fusha e Rrezikut	Pershkrimi i rrezikut	Masa e propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizimit	Mjetet e verifikimit	Vështërsitë	Rekomadimet
1.	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	Mos definimi i përgjegjësi në mes të drejtorive, sektorëve dhe zyrtarëve për obligimet që i kanë në lidhje me menaxhimin e pronave komunale.	Zbatimi i procedurës së shkruar dhe të aprovuar nga ZKA për menaxhimin e të hyrave nga pronat komunale.	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	6 muaj	Raportimet e periodike dhe vjetore për fushat nga secila drejtori dhe sektor.	E Realizuar	Raportet dhe komisionet përkatëse.		
2.		Dhënja me qira e objekteve dhe tokave komunale në palë të treta pa u informuar Komuna.	Inspektimi në baza gjashtë mujore nga komisioni përkatës për monitorimin e pronave.	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	6 muaj	Komisioni për mbikqyrjen e pronave në periudha gjashtë mujore bën verifikimin dhe kontrollimin e shfrytëzuesëve të pronave komunale duke raportuar për secilin pronë.	E Realizuar	Raportet periodike të Komisionit.		
